



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Integritim Evropian**

**Mbledhja nr. 39**

**Prishtinë, më 04.03.2019 në orën 10:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ismet Beqiri, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milaim Zeka.

**Munguan:** Zenun Pajaziti dhe Adem Hoxha.

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

**E ftuar:** Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian.

**Mbledhjen e kryesoi;** Blerta Deliu-Kodra, kryetare e komisionit.

**Kryetarja e komisionit,** pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë;

**Rend Dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.02.2019;**
- 3. Raportimi i znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian për zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ERA);**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjin nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Të ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua i pa ndryshuar.

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.02.2019;**

Procesverbali, i mbledhjes së kaluar, u miratua pa vërejtje.

### **3. Raportimi i znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian për zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ERA)**

**Kryetarja** falënderoi ministren për pjesëmarrje dhe tha se ju kemi ftuar që të raportoni lidhur me përmbushjen e veprimeve nga ana e institucioneve tona sa i përket PKZMSA për vitin 2018, si dhe ERA-së, në mënyrë që të shohim se cilat kanë qenë të arriturat dhe ngecjet në këtë drejtim dhe të mundohemi që me një bashkëpunim më të madh mes institucional të avancojmë rrugën tonë drejt përmbushjes së obligimeve tona, pasi siç e dimë se, varësisht nga përmbushja e këtyre obligimeve, kemi edhe avancimin e rrugës drejt integritimit.

Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, ne nuk kemi marrë ndonjë informatë konkrete se cilat janë pritjet e juaja dhe se nëse keni ndonjë informacion se në çfarë kohë pritet të përfundojë ky proces. Bashkëpunimi i shteteve të Ballkanit Perëndimor është kërkesë dhe fokus i Bashkimit Evropian, andaj siç e dimë tashmë, Procesi i Berlinit do të jetë edhe forma përmes së cilës do të mbahet ritmi integrujes i Ballkanit.

Prandaj dëshiroj të di se në cilat fusha ka përfituar Kosova nga ky proces dhe cilat janë obligimet të cilat i ka Kosova në këtë proces? Po ashtu, dëshiroj të di se cila është qasja e Presidencës së tanishme të BE-së, e cila siç e dimë kryesohet nga Rumania dhe se a pritni që në Presidencën e radhës çështja e shteteve të Ballkanit e veçanërisht e Kosovës të jetë në fokus?

Është me interes të na informoni edhe për fondet e IPA-së se cilat janë përfitimet që po bëhen në këtë drejtim sepse kemi pas informata nga mediat se këto fonde nuk po shfrytëzohen mirë.

**Donika Kadaj-Bujupi** tha se në takimet e mbyllura me përfaqësuesit e ambasadave, javën e kaluar na është thënë që në muajin tetor dhe nëntor ka pas një përpjekje shumë intensive për realizimin e përpjekjes sonë për liberalizim, ndërsa po sa është përmbyll viti është hesht dhe nuk po shohim ndonjë veprim konkret nga ana juaj, a mund të na informoni se çfarë veprimesh keni marrë në këtë drejtim.

**Dhurata Hoxha, ministre për Integritime Evropiane** tha se raportimin e sotëm do ta ndaja në 3 pjesë: lidhur me zbatimin e PKZMSA, pastaj zbatimin e ERA 1, kur ka fillua dhe ka hyrë në fuqi, marrëveshjet për zbatimin e ERA 2016-2019 dhe për fondet IPA.

Sa i përket zbatimit të MSA-së për vitin 2018, i ka tejkaluar planet tha se ka rezultate inkurajuese ne zbatimin e PKZMSA dhe agjendës evropiane për reforma dhe caku i zbatimit të PKZMSA-së për vitin 2018ka qenë 60%, ju falënderoj edhe juve, si komision, për bashkëpunim me ngritjen e temave shumë te rëndësishme në këtë kuadër dhe ky angazhim i përbashkët ka bërë që të tejkalohet plani dhe të zbatohet me 68.23%.

Institucionet e Kosovës në përgjithësi kanë treguar performancë më të mirë gjatë vitit 2018 në rritje prej 6%. Tejkalmi i planit të paraparë të zbatimit të PKZMSA-së për vitin 2018 po demanton zërat se ka pas ngecje, pra gjithsejtë nga 532 janë zbatuar 362 masa, ndërsa pjesa tjetër prej 169 masave nuk kanë arritur të zbatohen plotësisht ne momentin e raportimit dhe janë në proces të zbatimit. Shkalla e masave legislative është 55.56%, pasi që 80 nga 144 masa janë zbatuar, ndërsa 44.4% nuk kanë arritur të zbatohen. Ne anën tjetër shkalla e zbatimit të masave zbatuese është 72.94% .

Gjithashtu jemi të përkushtuar që gjatë vitit 2019 ta rrisim dinamikën e zbatimit të masave legislative dhe masave të tjera në përgjithësi, ndërkohë përkundër rezultatit të mirë të nivelit të masave zbatuese po përpiqemi ta rrisim këtë dinamikë dhe t'i tejkalojmë planet. Tani ne kemi rishikuar PKZMSA për vitin 2019-2023 dhe shumë shpejt do të miratohet në Qeveri dhe pastaj edhe në komisionin tuaj. Sipas planeve të dakorduara me BE-në, caku i zbatimit të PKZMSA për këtë vit do të jetë 70 %, kurse për vitin 2020 do të jetë 80 %.

Javën e kaluar Ministria e Integriteteve ka ftuar të gjitha institucionet, përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës, që të merren me prioritet të lartë zbatimin e prioritetëve afatshkurtra të PKZMSA 2019-2023 dhe qëllimi ynë është që plani i zbatimit të tejkalohet si në vitet paraprake.

Sa i përket raportimit për zbatimin e ERA-së për vitin 2016-2019 rezultatet janë inkurajuese dhe niveli i zbatimit gjatë kësaj periudhe është 71.85%, pasi 97 nga 135 veprime janë zbatuar plotësisht, ndërsa 38 prej tyre janë ne zbatim e sipër. Nga 22 prioritet 10 janë të plotësuar plotësisht, kurse 12 tjerat janë në zbatim e sipër dhe në asnjë veprim nuk kemi zero zbatim ,të gjitha janë në progres e sipër. Raportin e detajuar te ERA-së do ta pranoni shumë shpejt.

Presim që gjatë vitit 2019 ta rrisim dinamikën e zbatimit të prioritetëve ERA 2 dhe ta rrisim dhe të përpiqemi t' i tejkalojmë planet edhe me këtë dokument.

Edhe në ERA ka demantim të zërave se kinse Kosova ka pasur ngecje në këtë drejtim, prioritetet që kanë mbetur të pa zbatuara janë prioritete që do të fillojnë të zbatohen edhe ne dokumentin e ERA 2 i cili është një dokument që përafërsisht mbulon shtyllat e njëjta, qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, arsimin apo konkureshmërinë, si dhe zhvillimin ekonomik. Prioritetet përafërsisht janë të njëjta dhe afati kohor zbatimit te ERA 2 është dy vjeçar.

Lidhur me fondet IPA tha se kohet e fundit kemi pasur zëra kinse Kosova ka humb miliona euro si rezultat i performancës së dobët të Qeveris së Kosova, këto janë përgënjeshtime sepse Kosova nuk ka humbur dhe nuk po humb asnjë centë nga BE-ja. Qeveria e Kosovës ka nënshkruar dy marrëveshje me BE-në dhe këto dy kontrata janë duke u zbatuar sipas afateve kontraktuale. Rishikimi i PKZMSA dhe ERA 2 bëhet në pajtueshmëri të plotë me BE-në.

Lidhur me procesin e Berlinit, gjegjësisht edhe Kornizën investive të Ballkanit Perëndimor, në këtë raund të aplikimeve pra raundi 21 i aplikacioneve vlera e projekteve me të cilat Kosova aplikon i tejkalon shumë prej 250 mi€ dhe projektet kanë të bëjnë me infrastrukturën, pra ndërtime të impianteve për ujëra të pijshëm dhe impiante për trajtimin e ujërave të zeza dhe kolektor të ujërave nëpër disa qendra të Kosovës dhe këto projekte e tejkalojnë vlerën prej 400 mil € Këto investime do të jenë grante të BE-së, kredi nga institucionet financiare dhe disa janë të parapara edhe nga buxheti i Kosovës dhe për të gjitha këto projekte duhet të sigurohemi që stabiliteti makrofiskal i vendit të ruhet.

E kemi diskutuar shumë herë edhe në këtë komision që ekziston një nevojë që të kemi një sistem të monitorimit të projekteve se sa po është efekti i këtyre projekteve dhe shumave të mëdha të parave që janë duke u investuar në Kosovë dhe rritjen e transparencës për qytetarët të Kosovës. Është një objektivi imi që të ndërtojmë një sistem mbikëqyrës për donacionet e jashtme që edhe Kosova ashtu, si disa vendet e rajonit, që të lëvizë direkt nga fondet e menaxhimit të BE-së në sistemin e menaxhimit indirekt të menaxhimit të fondeve të BE-së, kjo do të marrë kohë dhe resurse dhe ne planifikojmë që sistemin për menaxhimin e fondeve të IPA ta ndërtojmë gjatë fazës IPA 3 dhe menaxhimi indirekt nënkupton që Kosova të menaxhojë fondet e BE-së si parapërgatitje për menaxhimin e fondeve strukturore të BE-së pas anëtarësimit në BE.

Lidhur me pyetjen për liberalizimin e vizave gjegjësisht takimeve, nuk qëndron çështja se ne nuk jemi aq aktiv sa në periudhën tetor-nëntor, sepse unë kam pasur takime të shumta në janar dhe shkurt dhe kam takuar vendet që kanë qenë hezituese dhe përkrahëse që ta koordinojmë përkrahjen për procesin e liberalizimit të vizave dhe të kërkojmë që pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian të trajtohet çështja e liberalizimit të vizave në Këshillin e Ministrave.

Vlen të përmendet që vendet që kanë qenë hezituese vazhdojnë të jenë hezituese, por kemi parë lëvizje nga Gjermania në drejtim pozitiv dhe nëse arrihet që Gjermania të ketë një qëndrim të qartë rreth liberalizimit të vizave, në qershor mund të ketë lëvizje. Kemi takime me zyrtarët e lartë të Rumanisë që e ka presidencën dhe në ato takime na është thënë se ata do të jenë ndërmjetësues të sinqertë, nëse arrihet të ndërtohet konsensusi në shtetet anëtare për të votuar për liberalizimin e vizave dhe nëse arrihet të bëhen votat e nevojshme, kanë konfirmuar se Rumania do të jetë një ndërmjetësues i sinqertë, por nuk mund të presim se do të kemi një qasje proaktive nga Presidenca Rumune për shkak të rrethanave që janë në Parlamentin Evropian, sepse nga gjysma e marsit dhe deri në përfundim të zgjedhjeve nuk mund të pritët asnjë lëvizje. Lidhur me pyetjen se a ndërlihet procesi i liberalizimit të vizave me taksën, ju them se nuk lidhet në mënyrë zyrtare nuk kemi marrë ndonjë dokument që në mënyrë të ndërlihur taksa mund të ndikojë me procesin e liberalizimit të vizave, por ne, si ministri, nuk kalon ditë që nuk kemi kërkesa nga vendet e BE-së që na drejtojnë kërkesat për suspendimin e taksës.

**Ismet Beqiri** tha se për mua është me rëndësi të them se një ndër pengesat kryesore janë zgjedhjet në Parlamentin Evropian, tash ata mund të arsyetohen drejt me këto zgjedhje kur nuk donë ose mendojnë se ende ne nuk duhet të kemi një lëvizje të lirë dhe kjo është e pa drejtë karshi qytetarit tanë, problemin më të madh që neve në takime na thonë, është se ne kemi probleme të mëdha në luftimin e krimit dhe korrupsionit dhe unë kuptoj pse ju

ministre nuk e thoni ose hezitoni, dhe ne nuk mund ta anashkalojmë këtë problem që është i theksuar te ne dhe ne po ashtu jemi të vetëdijshëm se kemi ose do duhej te kemi ndarje te pushteteve, megjithatë kjo është një pengesë që na thuhet çdo kund, kanë rezervë karshi nesh dhe arsyeja kryesore është që në Kosovë ka korrupsion, ka krim të organizuar dhe mungesë të sundimit te ligjit.

Andaj në këtë drejtim është mirë që të gjithë ne, në formë deklarative dhe përmbajtjesore ta bëjmë se fokusi ynë është që të luftohet krimi dhe korrupsioni, sepse në BE nuk dëshirojnë t'u shtohet edhe një shtet ku nuk ka mungesë të krimit dhe korrupsionit dhe kjo është evidente dhe janë shumë raste të rralla apo të izoluara që po dënohen për këto veprime të pa ligjshme. Krejt të tjerat mund të na thonë se jemi në rregull ose afërsisht, por në këtë drejtim jemi duke çaluar dhe kjo gjendje është pengesë e madhe të ecet përpara. Në shumë takime që kemi me deputetët e Evropës na thonë çdo herë, ju duhet të bëni shumë më tepër në këtë drejtim dhe ne do të jemi problemi më i madh për BE, nëse nuk dimë dhe nuk veprojmë ashtu si kërkohet me rregullativa.

**Milaim Zeka** tha se është bërë një gabim politik nga të gjitha partitë politike dhe liderët politikë prej fillimit e deri në mbarim, sepse çdo herë kur është adresuar pyetja se kur do të liberalizohen vizat, nuk kamë dëgjuar që asnjë udhëheqës politik ka thënë këtë pyetje, drejtohuni kah Brukseli, e jo te ne.

Vendimi i vizave ka qenë, është dhe do të jetë vendim politik, kështu që ne nuk është mirë me u lodhur në këtë drejtim, por është mirë që me u lodhur në përmbushjen e obligimeve dhe detyrat tona, në radhë të parë të përcaktuara nga qytetarët tonë, e në radhë të dytë nga BE dhe nga SHBA që na japin detyra. Te menaxhimi i fondeve publike mendoj se këtu duhet të kemi shumë kujdes sepse jemi nën monitorimin e BE-së, pa hyrë te parafolësi që me shumë të drejtë e tha që pjesë kryesore e krejt debatit në çdo takim që e kemi është sundimi i rendit dhe ligjit.

Jemi 20 deputetë me akuza dhe aktakuza dhe tani lind pyetja, nëse Presidenti e ka kapur nyje prokurorinë e shtetit dhe e përdor për me i ngrit aktakuzë kujt të dojë dhe nëse për shkak të përplasjeve politike, inateve politike dhe fushatave politike arrin me u atakuar ambasadorja jonë në Uashington, Amerikanët dhe Evropianët thonë këtu diçka nuk është në rregull.

Nuk i ngritët aktakuzë një deputeti apo politikani për hakmarrje politike dhe vetë fakti që po dështojnë këto aktakuza tregon se prokuroria është e zhytur deri në fyt.

Ne vazhdim pyeti ministren, pse nuk ka projekte p.sh. të cilat ne i kemi dërguar te BE-ja për fondet për të cilat ne po aplikojmë, nuk kemi asnjë projekt për riciklimin e mbeturinave, po e marrë një shembull se si në Poklekë të Drenicës është shkatërruar burimi i ujit të thartë dhe ka pasur interesim prej Sllovenisë dhe Kroacisë me ardhur me e ndërtuar fabrikën më moderne për ujë mineral, kurse sot ujërat e zeza e kanë vërshuar dhe kanë bërë shpime në shumë vende dhe e kanë shkatërruar atë burim, andaj sugjeroj të koncentrohemi me projekte të tilla dhe nuk di a ka hapësirë, por me pasur fuqi personale ju kisha drejtuar BE-së projekte për ndërtimin e Azilit të pleqve në çdo komunë, ose së paku 5 në gjithë Kosovën dhe mbi të gjitha pa ndërtuar çerdhe në çdo fshat të Kosovës ne nuk mundemi me ec si shoqëri. Pastaj kritikë po marrim edhe te qasja në dokumente

publike, gazetarët nuk kanë mundësi me u qas në dokumente publike, por as ne si deputet nuk kemi qasje.

**Armend Zemaj** tha se nuk pajtohet me interpretimin e raportit që e bëri ministrja sa i përket zbatimit të PKZMSA, për MSA-në gjatë vitit 2018, ju cituat disa shifra dhe masa, por interpretimi brenda këtij raporti tregon të kundërtën. Po e filloj nga zbatimi i masave në tërësi, ju nuk keni planifikuar 60% por keni planifikuar 532 masa, ndërsa janë zbatuar vetëm 363 që i bien 68% të masave, pastaj pjesa tjetër prej 31.77 nuk është zbatuar dhe kjo nënkupton të gjitha ministritë e linjës edhe agjencitë e tjera që kanë detyrime në zbatimin masave, vetëm dy ministri dhe disa agjenci të pakta i kanë zbatuar tërësisht masat 100%.

Kjo e pengon procesin integruar të Republikës së Kosovës, ju e potencuat se asnjë institucion nuk ka zero masa, po ka zero masa p.sh. te bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare asnjë masë nuk është zbatuar. Në kuadër të kësaj ka humbje edhe të fondeve nëse i referohemi prapë këtij raporti, 11 kushtet e kërkuara që nuk janë plotësuar dhe këtu nga 25 mil. Gjatë vitit 2018 Kosova ka humbur 14 mil. Këto janë disa çështje që neve na bëjnë skeptik si Qeveri, nuk po flas si Ministri e Integriteteve sepse ju jeni bartës të monitorimit të këtij procesi dhe këtu shihet se Qeveria nuk i ka prioritet integritet evropiane, sepse po t'i kishte prioritet së pari do ta ngjiste nivelin e imazhit të saj i cili është nën zero, ministra nën akuzë dhe ajo që shihet pothuajse gjatë vitit 2017-2018 asnjë vizitë e nivelit të lartë as nuk ka ndodhur në Kosovë dhe as e krerëve institucional jashtë Kosovës dhe kjo tregon se ne çfarë gjendje jemi, përjashtuar pjesëmarrjen në organizata ndërkombëtare, por sa i përket vizitave bilaterale kjo është nën nivelin e përgjegjësisë.

Te arsimit njëra ndër masat ka qenë të ndërtohen 8 çerdhe gjatë vitit të kaluar, por asnjë nuk është ndërtuar dhe kjo tregon se një shtet që nuk ka mundësi të ngrit kapacitetet bazike arsimore, ndërsa ne pretendojmë të jemi pjesë e familjes së madhe evropiane dhe kjo është logjika fatkeqësisht si funksionon kjo qeveri.

Ju vitin e kaluar ministre keni qenë në Kuvendin e Kosovës në interpelancë të thirrur nga LDK-ja ku është miratuar një rezolutë ku është kërkuar ta sillni një raport brenda dy javëve për plotësimin e PKZMSA-së, por kjo nuk ka ndodhur.

Sot nuk kemi asnjë mpaktë pozitive që mund të krenohemi për vitin 2018, pavarësisht kësaj përqindje të zbatueshmërisë nëse mund të themi se është e kënaqshme ne pjesën prej 68% dhe vizat nuk ndodhen dhe përgjegjësinë e ka Qeveria për gjithçka që e dëmton procesin integruar në vend. Sot shumë qytetarë presin para ambasadave për viza dhe kjo as nuk potencohet dhe as nuk analizohet pse qytetarët e Kosovës janë të detyruar të kërkojnë punë dhe jetë më të mirë.

Andaj ju kisha lutur që kur e paraqitni zbatimin e MSA-së, ju e dini që disa anëtarë të këtij komisioni janë pjesë edhe e Komisionit të MSA-së dhe kemi kontakte dhe takime që janë të faktura dhe implementuara në plotësi nga pjesa mbikëqyrëse e Komisionit Evropian. Andaj mendoj se me këtë qasje Kosova është duke shkuar në degradim sa i përket raporteve me BE-në, por tani kemi dalë edhe përtej saj, edhe raporteve me SHBA-në.

**Fatmire Kollçaku** tha se raportin të cilin e kemi përpara i referohet të gjitha dikastereve qeverisë dhe agjencive tjera në përmbushjen ose në mos përmbushjen e masave, prandaj e juaja është ministre se a do ta merrni mbi supë krejt barrën e moszbatimit të masave sepse

ishit shumë dashamirëse karshi këtyre dikastereve dhe prita tone më kritike në raport me moszbatimin, andaj mos e merrni si personale. Ju e dini që takimet e fundit ishin në tone shumë optimiste, sa i përket liberalizimit të vizave i cili nuk ndodhi dhe është qartë se nuk mund t'i adresohet faji BE-së që ka thënë se janë përbush kriteret, prandaj ne fillim duhet ta bëjmë një dallim çka është miratimi i kriterëve, siç është miratimi i një ligji i cili pastaj duhet të nxjerrën shumë akte nënligjore, pastaj zbatimi i ligjeve dhe ne këtu çalojmë, çka të themi për sundimin e rendit dhe ligjit për deri sa ne kemi ministra që nuk e dinë se a është më keq që kanë përdorë armë dhe kanë dalë publikisht, apo që kanë thënë se nuk kanë ditë se është vepër penale përdorja e armës, njëri prej tyre në atë kohë nuk ka qenë ministër, por pastaj është graduar dhe është bërë ministër dhe në këtë qeveri ndodh një njeri i tillë i cili i ka rrezikuar të tjerët të bëhet ministër.

Mos harroni se partnerët tonë ndërkombëtarë e përcjellin krejt skemën politike dhe atë çka keni prezantua sot ministre, kisha me besuar që jam diku në Gjermani e më së paku në Kosovë.

Ne përmbushjen e masave, në fund të listës janë Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë si dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe kjo është për keqardhje, sepse sa i përket punëve të jashtme kjo ministri ka dështuar, pse nuk ndodhi liberalizimi i vizave vitin e kaluar edhe pse na thoshin se janë plotësuar të gjitha kriteret, nuk ndodhi sepse kriteri kryesor që është luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit nuk ka ndodhur seriozisht dhe ne të gjithë duhet të pajtohemi. Në fund tha se kërkoj që të fokusohemi në zbatimin real në terren, për gjithë atë që ne po proklamojmë me letra se ne me letra dhe me legjislacion jemi mirë, por krejt për çka çalojmë ne, është zbatimi dhe ky është modeli më i keq që e japim ne te ndërkombëtarët.

**Visar Ymeri** tha se në takimet e tilla do të ishte e udhës të përqendrohemi në çështje konkrete që i kemi këtu si temë për të cilën jemi duke folur. Mendoj se mënyra se si është shkruar raporti e kam është mënyra se si institucionet e Kosovës e trajtojnë procesin e integriteteve evropiane, për mua me tepër është teknik e statistikë dhe pak politikë e përmbajtjesor, sepse kur flitet këtu për masat e zbatuara për masat e zbatuara, 30%-40%-50%, ta krijon një farë përshtypje të një procesi në të cilin nuk ka fort interesim dhe rrjedhimisht mund të ketë shumë neglizhencë.

Për mendimin tim kjo përçindje e moszbatimit të masave e cila në fusha të caktuara te institucionet e caktuara ka përmasa alarmante, e shndërruar në statistikë kjo ta krijon një përshtypje të gabuar sepse ka institucione që kanë përmbush 50% të masave dhe i kanë pasur vetëm dy dhe e kanë përmbushur njërin dhe kjo është një farë iluzioni optik thua se disa institucione kanë qenë të suksesshme dhe disa jo, kurse ka institucione që i kanë përmbushur 10 masa e kanë arritur 30%, në këtë drejtim e kemi një keq orientim të diskutimit për çështjen që po flasim.

Te masat e pa zbatuara është dashtë ta kemi një shpjegim se cilat janë shkaqet kryesore të mos zbatimit të masave, veçanërisht Kuvendi duhet të informohet, ta saktësojmë nëse njëra prej këtyre 4-arsyeve që do t'i përmendi është arsyeja e moszbatimit të masave.

Pra, a ka vështirësi objektive në kuptimin që ta zëmë se ka masa të cilat varen nga masat paraprake dhe moszbatimi i një mase paraprake e pamundëson të dytën e kështu me radhë, megjithatë po flasim për një tërësi të masave institucionale që kanë ndër lidhshmëri njëra

me tjetrën, nuk mund të zbatohet secila masë në vete pa pas një mjedis institucional legjislativ në të cilën ajo mund të zbatohet, kjo është njëra prej shkaqeve që pamundëson zbatimin e disa masave. E dyta mund të jetë neglizhenca, a ka shpërfillje nga institucionet për sa i përket masave të cilat dalin si rezultat i obligimeve nga MSA, e treta është, mosdija, paaftësisë së administratës shtetërore për t'i përmbushur këto masa, dhe kjo është si rezultat i historikut të ndërtimit të administratës së Kosovës dhe e 4-ta mund të jetë ndërhyrja e drejtpërdrejt politike për pamundësimin e disa masave të cilat mund të bien ndesh me politika të caktuara të personave të caktuar brenda institucioneve të Kosovës. Ky lloj shndrimi prej një sistemi të ftohtë statistikor e shpërfaqë një lloj distancimi që institucionalisht mund ta kemi prej interesit të Republikës së Kosovës dhe dhënia e rëndësisë për punën tonë në masat që kërkohen nga të tjerët.

Ne një farë mënyre këto mase duhet të zbatohen se po na kërkojnë të tjerët e nuk e diskutojnë fortë rëndësinë e këtyre masave për përmirësimin e jetës sonë në Republikën e Kosovës.

Andaj kisha pas dëshirë që jo vetëm ministria juaj dhe kjo Qeveri, por krejt ata që marrin pjesë në skenën publike dhe janë përfshirë në angazhimin politik të fillojmë ta ndërrojmë qasjen karshi interesave të Republikës së Kosovës, interesin e përgjithshëm, duke parë këtë si rrugë të drejtë në BE, e jo ta bëjmë këtë për hir të BE-së, duke e forcuar dhe fuqizuar Republikën e Kosovës i afrohemi BE- së.

Meqë u ngrit çështja e liberalizimit të vizave, ne e kemi diskutuar në komision disa herë edhe nevojën që të përfshihet Kuvendi në një proces të lobimit, me vendet e BE-së, veçanërisht ato vende të cilat kanë një qëndrim ngurues, në disa takime që kishim me ambasadorët na është thënë se ka një ngritje të shqetësimeve nga disa shtete të BE-së, veçanërisht në sektorin e sundimit të ligjit dhe ngecjet të cilat Republika e Kosovës i ka treguar pas miratimit të vendimit pozitiv të Parlamentit, të gjithë jemi të vetëdijshëm që këtu nuk është një faktor që është duke dështuar në këtë proces dhe qasja e vendeve anëtare të cilat kanë një qëndrim ngurues prapë është e nxitur nga disa faktorë, që janë edhe politikat e brendshme dhe zgjedhjet e brendshme në BE, e që janë bërë problem për shumë prej shteteve të BE-së rritja e ekstremit të djathtë, janë pastaj edhe disa shtete që dëshirojnë ta shndërrojnë liberalizimin e vizave në një lloj karote për çështje tjera për të cilat Republika e Kosovës duhet të tregojë konstruktivitet, sidomos me dialogun me Serbinë dhe pastaj janë vendet të cilat kriteret e vlerësimit sa i përket sundimit të ligjit i kanë më të larta.

Mënyra e trajtimit të problemit ku thuhet se nuk keni lëvizur kënaqshëm në sundimin e ligjit, rrjedhimisht procesi i liberalizimit do të vonohet, mendoj se është një trajtim i pa drejtë karshi Republikës së Kosovës dhe kjo tregon edhe për mungesën e bashkërendimit të qasjeve të vendeve anëtare të BE-së karshi Kosovës.

**Ismajl Kurteshi** tha se diskutimin tim do ta filloj me kapitullin 25, ku sipas raportit obligimet janë përmbushur 100%, dhe objektivat shkenca dhe obligimet shkencore janë plotësuar, mirëpo dihet që nuk kemi sektor që qëndron më keq se ky sektor edhe pse në hulumtime shkencore investohet shumë pak. Po dyshoj se planifikimi nuk ka qenë në rregull, apo sipas planifikimit nuk është synuar që kjo fushë të përmirësohet gjatë vitit 2018.



Pastaj në kapitullin 26 ku bëhet fjalë për arsimin dhe kulturën, e ku arsimit në Republikën e Kosovës sipas një Rezolutive të aprovuar para dy viteve është prioritet kombëtar janë plotësuar vetëm 20% të masave dhe kjo është shumë brengose. Në vazhdim tha se duke pasur parasysh që në fushën që është përfolur më së shumti gjatë vitit të kaluar, të liberalizimit të vizave po edhe Interpolin, ne, si vend kemi dështuar, por faji nuk mund të jetë vetëm te ata jashtë, por edhe te ata brenda dhe mendoj se më shumë është brenda se sa jashtë, andaj pyes se a ka ndryshuar strategjinë ministria që ju e drejtoni që mos të ndodhë që edhe ky vit të jetë vit i dështuar sa i përket integriteteve evropiane?

Ju thatë se nga menaxhimi direkt i investimeve të BE-së ju keni vendos të kaloni në menaxhimin indirekt dhe investimet të monitorohen, a do të thotë kjo se tani është ndërruar mënyra e investimeve?

Sa i përket taksës që thatë po rritet kërkesa për heqjen e saj, nuk e di sa Qeveria e Kosovës dhe ju si Ministri e Integriteteve po ju shpjegoni atyre se Serbia vërtet si agresor dhe armik i Kosovës i ka shumë borxh Kosovës dhe nëse fillojmë me kushtëzime, Kosova i ka 100 kushte para se me hy në bisedime dhe se taksa nuk do të duhej me qenë pengesë, por vullneti i Serbisë që të ulet me Kosovën dhe ta pranojë pavarësinë dhe ta trajtojë atë drejt është problemi kryesor në këtë drejtim. Një çështje tjetër, duke pas parasysh një e pjesë e mirë e asaj që është planifikuar gjatë vitit të kaluar nuk është realizuar dhe pastaj ajo ka ndikuar në mos përmbushjen e detyrave të planifikuara dhe a ka sanksionime për ata individë që në Qeveri marrin përgjegjësi të caktuara, andaj a mund të na njoftoni se cilat janë masat sanksionuese për ata individë që nuk i përmbushin obligimet e tyre.

**Kryetarja** njoftoj se nga mediat e kishte marrë njoftimin se anëtari i bordit Osman Ejupi, anëtar i bordit të Telekomit të Kosovës ka dhënë dorëheqje dhe tha se si shqetësim serioz shumë shpesh në Raportin për vendin ka qenë i adresuar, depolitizimi i bordeve publike, andaj po konsideroj se rastet e tilla nuk duhet të përsëriten më dhe sundimi i ligjit të ketë një arbitraritet.

**Milaim Zeka** tha se fjalën e mora prapë për shkak të kundërshtimit tim ndaj deklaratave politike të deputetes Fatmire Kollçaku, më duket se këta muaj të fundit ekstremisht je polemizuar dhe ja bërë një farë forme përkrahëse e ideve qind për qind komuniste, që gjithçka me e bë zë dhe terr dhe me u marr me gjëra aq banale siç është rasti i gjuajtjes me armë, kur e din ti se te vetmin faj që e kanë bërë këta është që nuk kanë gjuajt me militova, siç kanë bërë koleget tuaj. Është mirë me fol së pari për punët e juaja të zeza, e pastaj me dalë te punët e të tjerëve.

Mos të vijmë nëpër komisione dhe me u bë rob i ideve që na çojnë dikush me SMS dhe me thanë kanë gjuajt. Janë shumë gjëra për të cilat mundesh ti me kritikë dhe qysh po mendoni me i çua agjendat e juaja politike duke u rrok me gjëra banale nuk po ju kuptoj.

**Fatmire Kollçaku** tha se duke iu falënderuar mediave që e kanë bërë publike, anëtari i bordit të Telekomit është ndëshkuar dhe këto gjëra ndodhin këtu. Unë nuk prita prej jush me i mbrojt ministrat që kanë gjuajtur me armë, megjithatë secili e jep mendimin e vet.

**Ministrja** tha se pa tjetër që sundimi i ligjit është sfidë dhe duhet të jetë dhe të mbetet prioritet fuqizimi i ligjit, besoj që angazhimi ynë po rritet ne sektorin e sundimit të ligjit, sepse është parakusht i të gjitha tjerave, e posaçërisht nëse kthemi te procesi i integritetit evropian, pjesët më të rëndësishme lidhen dhe do të lidhen kur të aplikojmë për statusin e kandidatit dhe kur të hapim statusin e kandidatit, sundimi i ligjit do të jetë ndër kapitujt ku do të monitorohemi shumë për së afërmi.

Mendoj se sa i përket liberalizimit të vizave kushti i rasteve të shenjzuara janë plotësuar dhe kjo tani nuk nënkupton që ne do të ndalemi, ne po insistojmë dhe kemi takime ku insistohet që numri i vendimeve përfundimtare nga gjykatat të rritet dhe të kemi procese efikase gjyqësore, një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe zbatimi i ligjeve dhe iniciativave legislative.

Te PKZMSA , zbatimi prej 68% është zbatim që i ka tejkaluar pritjet dhe tani masat e zbatimit janë masa që janë bërë në koordinim të plotë me zyrën e BE-së dhe ato janë masa të identifikuar nga institucionet veç e veç.

Kurse sa i përket mënyrës së zbatimit të masave të zbatuara dhe të pa zbatuara, fillimisht raporti i parë ka qenë më tepër raport narrativ dhe ne si ministri kemi pasur kërkesa që raporti të jetë më tepër më i detajuar dhe kjo më pak po na distancon nga veprimet sepse po i kthen veprimet në përqindje konkrete, mirëpo kjo është kërkuar edhe nga institucionet tona dhe nga BE-ja në mënyrë që të bëhet monitorimi i zbatimit të MSA në mënyrë sa më të saktë.

Zbatim numërohet vetëm masa që është zbatuar qind për qind, e jo masat të cilat janë ne zbatim e sipër. Për masat e jo zbatuara jemi duke i diskutuar dhe trajtuar dhe qysh javën e kaluar kemi pasur takimin e këshillit ministror dhe në atë takim kemi përmendur të gjitha institucionet që nuk kanë progres të duhur në zbatim të MSA-së.

Sa i përket projekteve me të cilat do të aplikojmë direkt apo indirekt, për momentin jemi në menaxhimin indirekt të projekteve, çka nënkupton se Kosova nuk merr pjesë në asnjë proces dhe të gjitha procedurat e hapjes, zgjedhje dhe monitorimit bëhen nga BE-ja, ndërsa ne po kërkojmë që të kalojmë në sistemin indirekt të menaxhimit i cili nënkupton që Republika e Kosovës do t'i kishte strukturat që do të përbëhen nga shumë mekanizma dhe shteti duhet të kalojë në struktura të licencimit në mënyrë që shteti ta fitojë të drejtën e menaxhimit të fondeve të IPA dhe ky është që qëllimi ynë në mënyrë që të kemi menaxhim më të mirë të fondeve strukturore me të cilat vendi do të përfitojë.

Sa i përket rezolutës u befasova që nuk keni marrë raport, sepse në qoftë në Kuvend dhe qoftë në komision dërgojmë raportet me rregull dhe do ta shohim pse nuk është dërguar me kohë.

Indikatorët që jemi pajtuar për diskursimin e përkrahjes suplementare buxhetore dhe janë zbatuar dhe presim fondet të diskutohen sipas marrëveshjes së nënshkruar të IPA 2, që dy pjesët janë për përkrahje buxhetore dhe me plot përgjegjësi ju them se nuk kemi humbur dhe asnjë cent dhe dy kontratat të cilat kanë vlerë prej 25 mil € janë kontrata duke u zbatuar dhe indikatorët janë përmbushur.

**Armend Zemaj** tha për hir të qartësisht tonë dhe të opinionit, diskursimi financiar tregon për vitin 2018 sa ka ndodhur nga marrëveshja e 2017 dhe a rrezikohet në vitin 2019 humbja eventuale nga ky 25 mil.

**Ministrja** tha se e përmenda se që diskursimi prej 25 mil €ne përmbushjen e indikatorëve për reformën e administratës publike është përmbushur dhe nuk ka humbje, ndërsa diskursimi prej 11 mil. veç ka përfunduar dhe Republika e Kosovës i ka marrë mjetet. Nuk kemi humbur fonde të IPA-së, por të zbatimit të projekteve dhe absorbimit të mirë të fondeve. Kosova për kokë banori është përfituesi më i madh i fondeve në rajon.

Lidhur me pyetjen për qasjen ne dokumente publike, sa i përket publikimit të gjitha shpenzimeve javore, Ministria e Drejtësisë ishte përzgjedhur si ministria më transparente dhe këtë të njëjtën gjë e kam urdhëruar edhe në Ministrin e Integritetit Evropian me qëllimin e vetëm që të jemi sa më transparent.

**Kryetarja** falënderoj ministren për raportimin dhe vazhdoj me pikën e radhës.

**4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

Lidhur me këtë projektligj kryetarja paraqiti opinionin ligjor dhe tha se çështjet e rregulluara dhe adresuara me këtë Projektligj, nuk janë të rregulluara me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Andaj konstatoj se Projektligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend. Hapi diskutimin dhe pastaj e hodhi ne votim projektligjin.

Pas votimit kryetarja konstatoj se komisioni me shumicë votash nxori këtë;

**Rekomandim**

**Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.**

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

**Përgatitur nga  
Njësia për mbështetjen e komisionit**

**Kryetare e komisionit,**

**Blerta Deliu-Kodra**

---